

## Pyetjet dhe përgjigjet në letërsi shqiptare

### 1. Cili është dokumenti i parë i shkruar në shqip?



Formula e pagëzimit

**Dokument i më i hershëm i shqipes së shkruar është “ Formula e pagëzimit” e vitit 1462.** Formula është gjetur në bibliotekën Laurentiana të Milanos nga albanologu rumun Nikolla Jorgo në vitin 1915.

Ndërsa dy dokumentet tjera nuk kanë të bëjnë me shqipen. Ilustrojnë vetëm pyetjen tonë.

*Västgötalagen* është njëri prej dorëshkrimeve më të hershme në suedisht i shkruar në vitin 1225 dhe ka të bëjë me ligjet rajonale suedeze.

*Hieroglifet* – ishin shkronja në forma vizatimore që përdorëshin në Egjiptin e lashtë 3000 vjet para Krishtit

### 2. Si quhet libri i parë i shkruar në shqip?



Meshari – libri më i vjetër shqip

**Libri i parë i shkruar shqip quhet “Meshari”.** E shkroi Gjon Buzuku në vitin 1555. Ekzemplari i vetëm i Mesharit u gjet nga ipeshkvi i Shkupit imzot Gjon Nikollë Kazazi në vitin 1740 me rastin e një vizite që i bëri bibliotekës së Kongregacionit në Romë. Originali ruhet në Vatikan kurse tri kopje të filmuara nga Justin Rrota në vitin 1929 janë sjellë në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Mesharin e kanë studiuar shumë gjuhëtarë. Në vitin 1968 Eqrem Çabej ka bërë një studim voluminoz dhe më shumë rëndësi.

### 3. Ku dhe kur u mbajt Kongresi i Alfabetit?



Ndërtesa ku u mbajt Kongresi i Manastirit

**Kongresi i Alfabetit të gjuhës shqipe u mbajt më 14 - 22 nëntor 1908 në Manastir.** Morën pjesë 150 delegatë nga qytete të ndryshme dhe nga klube e shoqëri patriotike brenda e jashtë vendit. Në mesin e delegatëve ishin edhe: Luigj Gurakuqi, Mithat Frashëri, Gjergj Fishta, Gjergj Qiriazi etj. Në këtë Kongres u vendos që shqipja jonë të përdorë alfabetin latin. Kryetar i Kongresit u zgjodh Gjergj Fishta kurse sekretare u zgjodh Parashqevi Qiriazi. Në Manastir filloi punën edhe shtypshkronja që pati rëndësi të veçantë për botimin e librave shkollor. Në këtë qytet u formua edhe Klubi i Manastirit që tuboi shumë intelektualë e patriotë shqiptarë.

### 4. Si quhet autori i Abetares së parë në gjuhën shqipe?



Naum Veqilharxhi

**Autori i parë i Abetares në shqip ishte Naum Veqilharxhi.** Veqilharxhi u lind në vitin 1767 në një fshat afër qytetit të njohur të Voskopojes. Ishte ideologu i parë i Rilindjes sonë, një mendimtar e iluminist i njohur. Si veprimtar i shkollës shqipe thoshte se vetëm mësimi i shqipes dhe ngritja e kulturës mund ta qonin atdheun në mesin e vendeve të qytetëruara .

5. Cili shkrimtar dhe me cilën veper konsiderohet nismëtar i Romantizmit në letërsinë shqiptare?



Jeronim De Rada

**Nismëtar i Romantizmit në letërsinë tonë konsiderohet Jeronim De Rada me veprën e tij romantike “Këngët e Milosaos”.** U lind në vitin 1814. Studioj letërsi antike e moderne në Itali. Ishte i ndikuar nga idetë e Revolucionit Francez. Shkroi veprat: “Këngët e Milosaos”, “Serafina Topia”, “Parimete e estetikës”, “Lashtësia e kombit shqiptar”, “Rapsodi të një poeme arbreshe”, “Skënderbeu i pafat” etj. Vdiq në vitin 1903 në moshë nëntëdhjetëvjeçare, në një dhomë të shkretë, pa dritë, pa bukë, pa zjarr duke lënë pas pikëllimin e gjithanshëm të arbëreshëve.

6. Si quhet albanologu i sotëm suedez që shkroi veprën “Mera hjältemod än vete”?



Ullmar Qvick

**Ky albanolog quhet Ullmar Qvick.** Flet për lakmi shqipen, është njohës i thellë i historisë e letërsisë sonë, veprimtar i shkollës shqipe në Suedi dhe përkrahës i hershëm i çështjes shqiptare. Ka shkruar disa herë për lidhjet letrare-kulturore shqipatro-suedeze.

7. Cili shkrimtar suedez është i përkthyer në gjuhën shqipe?



Astrid Lindgren

**Në gjuhën shqipe është përkthyer shkrimtarja suedeze e njohur në gjithë botën Astrid Lindgren.** Vepra e përkthyer shqip quhet “Pipi çorapegjata”. Kjo shkrimtare suedeze është përkthyer në mbi 60 gjuhë të botës.

8. Kush është autor i këtyre veprave: “Dr. Gjilpëra”, “Shqipëria kopsht shkëmbor i Europës juglindore”, “Katër përralla nga Zullulandi” dhe “Albania” ?



Faik Konica (1875-1942)

**Autor i këtyre veprave është Faik Konica.** Konica u lind në vitin 1875 në Konicë. Nga romani i pa përfunduar i Konicës “Dr. Gjilpëra” mësojmë për të parën herë për Universitetin e famshëm të Uppsalës, për suedezët dhe për peizazhet e bukura të këtij qyteti. Konica e viziton personalisht Uppsalen. Ishte personaliteti më i dijshtëm i botës shqiptare. Apolineri e quante “Enciklopedi që ecën”. Botoi revistën “Albania” “Katër përralla nga Zullulandi” dhe la dorëshkrim veprën “Shqipëria kopsht shkëmbor i Europës juglindore”. Vdiq në Amerikë në vitin 1942.

9. Cili prej vëllezërve Frashëri konsiderohet Bilbil i gjuhës shqipe?



**Bilbil i gjuhës shqipe është quajtur më të drejtë Naim Frashëri.** U lind në Frashër në vitin 1846. Ishte poet i madh – ikonë e poezisë shqipe. Naimi ishte inteligjent, i edukuar dhe shkollur që fliste perfekt: shqip, anglisht, frëngjisht, turqisht, persisht, greqisht, dhe arabisht. Përktheu fabulat e La Fontenit në shqip dhe shkroi veprat: “Histori e Skënderbeut”, ”Lulet e verës”, “Qerbelaja”, “Bagëti e bujqësi” e shumë vepra tjera shkollore. Vdiq në Stamboll në vitin 1900. Ishte aq i dashur sa që dikur në çdo dytën familje shqiptare kishte një fëmijë të pagëzuar me emrin Naim në shenjë respekti për këtë Bilbil të gjuhës sonë.

10. Në suedisht janë përkthyer deri më tash njëmbëdhjetë vepra të Ismail Kadaresë. Si quhen këto vepra të Kadaresë në gjuhën shqipe?



“Den döda armens general ” 1973 (Gjenerali i ushtrisë së vdekur)  
“Krönika i sten” 1975 ( Kronikë në gurë )  
“Drömmarnas palats” 1992 ( Pallati i ëndrrave )  
“Grymma april” 2007 ( Prilli i thyer )

11. Gjej shkrimtarët që kanë shkruar kryesisht letërsi për fëmijë?

Letërsi për fëmijë kanë shkruar këta shkrimtarë:  
**Rexhep Hoxha dhe Astrid Lindgren**

12. Kush është autori i kësaj vjershe të bukur për gjuhën shqipe?

**Përmbi za që lshon bylbyli,  
gjuha shqipe m’shungullon,  
përmi er` që jep zymbyli,  
pa da zemrën ma ngushllon.**

.....  
**Geg´ e tosk´, malsi jallia  
janë një komb m´u da s´duron;  
fund e maj´ nji a Shqipnia  
e një gjuh` t´gjith´ na bashkon.**



Ndre Mjeda

**Autor i kësaj vjershe të bukur për gjuhën shqipe është Ndre Mjeda.** U lind në vitin 1866 në Shkodër. U shkollua në Spanjë, Itali, Poloni e Kroaci kryesisht për fe. Por, Mjeda mbeti Poet i madh - poet që shkroi pak por aq bukur sa nuk bën më mirë. Veprat e tij janë: “Juvenilia”, “Liria”, “Lisus”, “Scodra” si dhe dy poemthate e bukur “Vaji i bylbylit dhe “I tretuni”.

13. Libri i parë i Ismail Kadaresë me poezi (e shkruan kur ishte gjimnazist) quhet?

**Libri i parë me poezi i Ismail Kadaresë quhet “Frymëzime djaloshare” dhe është shkruar në kohën kur autori ishte në shkollë të mesme. Kadare është mjaftë i fuqishëm edhe si poet por në gjirin e madh të letërsisë botërore njihet kryesisht si njëri nga prozatorët më të famshëm të fundshekullit XX .**

14. Kush është autor i gjithë këtyre romaneve e poezive aq të bukura për fëmijë?

Romane: “Bardhi e Mirushja” poezi: “Zogu i Lasgushit”  
“Lepuri me pesë këmbë” “Deti u bëftë kos”



Rifat Kukaj

**Autor i gjithë këtyre veprave të bukura është Rifat Kukaj. U lind më 1933 në Drenicë. U shkollua në Prishtinë. Është një nga shkrimtarët më të mirë për fëmijë. Për punën e tij të frytshme është shpërblyer me shumë tituj, si bie fjala: “Ismail Qemal Vlora” në Shqipëri, “Oton Zhupancic” në Slloveni, “Ivan Goran Kovaciq “ në Kroaci, “Neven” në Serbi, “Zmaj” në Vojvodinë, “Shpërblimi i dhjetorit” në Kosovë. Vdiq në Prishtinë më 2005.**

15. Kush është autor i këtyre veprave:


“Album”, “Historia e Skënderbeut”, “Autobiografia”, “Izraelit e Filistin”,  
“Betoveni dhe Revolucioni francez”.



Fan Noli  
1882 - 1965

**Autor i këtyre veprave është Fan Noli. U lind më 1882. Ishte shkrimtar, përkthyes, diplomat dhe kryepeshkop. Noli është një figurë tjetër poliedrike shqiptare. Përveç veprave origjinale ai përktheu në shqip edhe Shekspirin, Servantesin , Omar Khajamin etj. Ishte edhe Kryetar i Qeverisë së parë Demokratike në Shqipëri. Drejtoi gazetën “Vatra” dhe formoi të parën kishë autoqefale shqiptare (të pavarur) në Amerikë. Ishte poliglot. Në një konferencë për shtyp në kohën kur ishte kryeministër la pa gojë të pesëmbëdhjetë gazetarët e pranishëm me aftësinë e tij për tu përgjigjur në gjuhët respektive të secilit.**

16. Cila fjali është tekst i Formulës së pagëzimit?



**Teksti i “Formulës së pagëzimit” është ky:**

**“ Unë të pagëzojë në emër të Atit, të Birit e të Shpirtit Shenjtë”.**

Këtë fjali të nënvizuar me të kuqe mund ta shihni edhe ju në faksimilen përbri. Në kohën kur u shkrua kjo formulë populli ynë luftonte kundër sulltanëve të Turqisë dhe më që ishte kohë lufte kryepeshkvi Pal Engjëlli jep urdhër që familjarët shqiptarë t’i pagëzojnë fëmijët e porsalindur në shtëpitë e tyre.

17. Në vitin 1933 botohet Kanuni i Lekë Dukagjinit - Kush ishte autori i këtij botimi?




Lekë Dukagjini



Shtjefen Gjeçovi

**Kanuni i Lekë Dukagjinit është botuar nga shkrimtari e patrioti i madh Shtjefen Gjeçovi në vitin 1933.** Kanuni i Lekës është monumenti më rëndësishëm i kulturës shqiptare në përgjithësi. Libri përmbledh kodet, normat e pashkruara të së drejtës zakonore që kanë mbretëruar mbi gjashtëqind vjet duke luajtur rol vendimtar në jetën e popullit tonë. Gjeçovi ishte shkrimtar, etnograf, arkeolog dhe prift i nderuar. Botoi këto vepra: “Agimi i Gjytetnisë-1910 dhe “ Kanuni Lekë Dukagjinit ”-1933. E vranë në pritë policët serb, pasi që ju kundërvu haptas politikës shtypëse të Serbisë më 13 tetor 1929 teksa po kthehej nga Prizreni për në kishën Zymit ku punonte si famullitar dhe mësues i shqipes.

18. Sa mendoni se është e hershme letërsia jonë për fëmijë? Kur ka filluar ajo?



Kostandin Kristoforidhi

**Vjersha më e hershme e shkruar për fëmijë në letërsinë tonë është ajo e Kostandin Kristoforidhit me titull “Ylli i vogël lart në qiell”. Ky vit e kjo vjershë konsiderohet si fillim i hershëm i letërsisë sonë për fëmijë.** Kjo vjershë u botua në Abetaren e Kristoforidhit në vitin 1872. Kristoforidhi bëri shumë për fëmijët dhe shkollën shqipe. Të mësojmë vjershën e tij:

**Ylli i vogël lart në qiell,  
duket porsì zjarr në pyll.  
Sipëri dheut lart qëndron  
Xixa, xixa xixëllon.**

19. Gjatë luftës në Kosovë më 1999 u vranë nga forcat serbe dy shkrimtarë të dashur për fëmijë. U vranë pse ishin shkrimtarë dhe shqiptarë pse shkruanin për lulet, fëmijët dhe lirinë. Ata i vranë duke besuar se ne do ti harrojmë. Por, ne do ti kujtojmë e do ti duam përgjithmonë. Cilët ishin ata?



Latif Berisha



Ymer Elshani

Forcat serbe gjatë luftës në Kosovë masakruan edhe dy shkrimtarë të njohur për fëmijë. Në Mitrovicë vranë në shtëpinë e tij shkrimtarin e profesorin e nderuar **Latif Berisha** kurse në Drenicë masakruan **Ymer Elshani** së bashku me shumë fëmijë, gra e burra. Latif Berisha ishte profesor i njohur i Letërsisë së Rilindje në Fakultetin Filologjik në Prishtinë dhe autor i librit me vjersha të bukura për fëmijë “Tufa”. Ymer Elshani ishte një nga autorët më të njohur në letërsinë e sotme për fëmijë.

20. Cili prej këtyre shkrimtarëve shqiptarë konsiderohet Baba i gjuhës shqipe?



Përmendorja e Kristoforidhit  
në Elbasan

**Baba i gjuhës shqipe konsiderohet Kostandin Kristoforidhi.**

Gjithë jetën e vet Kristoforidhi ia kushtoi shkollës dhe gjuhës shqipe. Për shkollën shqipe shkroi abetaren e shumë libra tjera dhe punoi me zell gjithë jetën si mësues. Për shqipen bëri gramatikën e saj në dy dialekte dhe tuboi për pesëdhjetë vjet aq shumë fjalë sa arriti të botoi edhe Fjalorin. Pra, vepra jetësore e tij është Fjalori i gjuhës shqipe. Do përmendur edhe ndihmën që Kristoforidhi i dha albanologut të madh Han për mësimin e shqipes dhe hartimin e fjalorit gjermanisht-shqip. Ka shkruar edhe një prozë të bukur me titull “Gjahu i malësorëve” në vitin 1902.

21. Brenda viteve 1508 - 1510 u botua për herë të parë në Romë në latinisht vepra “Historia e Skënderbeut”. Kush e shkroi “Historinë e Skënderbeut” ?



Ballina e Historisë  
së Skënderbeut

Marin Barleti

**Marin Barleti është kronisti dhe historiani i parë që shkroi për jetën e luftërave të Skënderbeut.**

Barleti ishte shkodran dhe fare i ri kishte luftuar personalisht për mbrojtjen e Shkodrës nga turqit. Kur ra Shkodra në Rrethimin e Dytë më 1478, Barleti u shpërngul në Itali. Atje studioi histori, letërsi klasike dhe gjuhë latine. Vepra që i solli famë është “Historia e Skënderbeut” e cila u botua në Romë dhe më vonë njohu 21 rimbote. Brenda një kohe të shkurtër është përkthyer në italisht, gjermanisht, portugalisht, polonisht, spanjisht, frëngjisht dhe anglisht.

Vepra e Barletit u bë literatura më e dashur e kohës për lexuesit evropianë dhe vepra prej se cilës një kontinent i terë mësoi për Skënderbeun dhe sakrificën e popullit tonë.

Barleti shkroi edhe “Rrethimin e Shkodrës” të cilën e botoi në Venedik në vitin 1504.

22. Para Luftës së Dytë Botërore kishim një shkrimtar shqiptar të propozuar për çmimin Nobel në letërsi. Për cilin shkrimtar është fjala?



Gjergj Fishta  
1871 - 1940

**Fishta është poet gjenial, epiku më i madh i letërsisë sonë, Homeri i shqiptarëve që para Luftës së Dytë është propozuar për Nobel.**

Fatkeqësisht, ky shkrimtar i madh për pesëdhjetë vjet është ndaluar, është sharë, është denigruar. Por fatmirësisht, veprat i kanë shpëtuar dhe populli ynë fshehtas e ka lexuar, e ka mësuar përmendsh, e ka përhapur gojarisht. Vepra më e njohur e Fishtës është “Lahuta e malësisë” për të cilën punoi 40 vjet dhe e botoi më 1937. Vepra të njohura të Fishtës janë edhe: “Mrizi i zanave”, “Gomari i Babatasit”, “Anzat e Parnasit” etj. Fishta u zgjodh Kryetar i Kongresit të Manastirit, punoi si mësues i shqipes dhe botoi revistat “Hylli i dritës” dhe “Posta e Shqypnisë”. Më 1931 Greqia i jep dekoratën “Foenix”, kurse në vitin 1939 Italia e bën anëtar të Akademisë së saj.

23. Kritika letrare studion veprën letrare kurse kritikët më të njohur në letërsinë shqiptare janë: ?

Kritika letrare shqiptare është edhe e pasur edhe e hershme në letërsinë tonë. Bie fjala në Letërsinë e Bejtexhinjve kemi të zhvilluar llojin e polemikës letrare, në Letërsinë e Rilindjes kemi kritikë të mirëfilltë kurse pas Luftës së Dytë kritika letrare ngritët në nivelin e disiplinës shkencore që studion veprën letrare. Sot, kritikët letrar më të njohur janë: **Rexhep Qosja, Razi Brahimi, Ali Aliu, Adriatik Kallulli, Hasan Mekuli, Ibrahim Rugova, Klara Kodra, Dhimitër Shuteriqi, Xhemajl Mustafa, Diana Çuli** e shumë të tjerë.

24. Kur përmendim këta emra: Gustav Majer, Erik Hans Thunman, Johan Georg fon Hani, Holger Petersen, Norbert Jokli, Ullmar Qvick, Robert Elsie etj atëherë flasim për:

**Albanologët e nderuar që bënë aq shumë për kulturën shqiptare.**  
*Gustav Majeri* (gjerman) botoi të parin "Fjalor etimologjik të shqipes";  
*Thunman* (suedez) konstaton: "shqipja është pasardhëse ilirishtes";  
*Hani* (gjerman) zbuloi fjalorin e Todhrit dhe bëri studime të shumta për shqipen prandaj më të drejtë quhet edhe baba i Albanologjisë;  
*Peterseni* (danez) studioi natyrën e brendshme të shqipes, botoi 10 përralla, 12 këngë, 18 gjëgjëza dhe 18 besime popullore;  
*Norbert Jokli* (gjerman me origjinë çifute) studioi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes;  
*Ullmar Qvick* (suedez) shkroi një vepër për shqiptarët kurse  
*Robert Elsie* (kanadez) është sot njëri nga njohësit më të mirë të gjuhës e letërsisë sonë dhe një nga përkthyesit më të mirë të saj në anglisht e gjermanisht.

25. Lexojmë një këngë për fëmijë. Fjalët që përputhen, pëlqehen bukur njëra me tjetrën në fund të vargjeve quhen?

<i>Mor` bubrrec, mor` bubrrec,</i>	<b>Kur fjalët përputhën në fund të</b>
<i>Ti gjith ditën ec e ec;</i>	<b>vargjeve atëherë kem të bëjmë me</b>
<i>Mbledh e mbledh e grumbullon</i>	<b>Rimën si një element të rëndësishëm</b>
<i>Pa me thuaj pse punon</i>	<b>të vjershërimit.</b>

26. Cila gazetë konsiderohet e para në historinë e gazetarisë shqiptare?

**Gazeta e parë në historinë e gazetarisë sonë besohet të jetë "Shqiptari i Italisë" e De Radës e cila doli në vitin 1860. Në këtë shekull ishte Rilindja Kombëtare shqiptare që bënte të qarta kërkesat kryesisht çlirimtare të saj para publikut vendor e ndërkombëtar. De Rada botoi edhe revistën e parë me titull "Flamuri i Arbrit" (1883-1887).**

27. Cilat gazeta botohen sot në Kosovë? Përmend së paku katër tituj.



Në Kosovë sot botohen shumë gazeta. Ja disa prej tyre:

**Kosova sot,  
Bota sot,  
Zëri,  
Epoka e re,  
Lajm,  
Exprsee,  
Infopres etj.**

28. Çka nënkupton njeriu ynë kur përdorë fjalën e urtë “Muri luan, burri s’luan “?

**Kur themi këtë fjalë atëherë mendojmë në Besën.**

Fjalët e urta kanë fuqi të madhe shprehëse. Janë pasuri e seciles gjuhë.

29. “Fjalori latinisht-shqip” është vepra e parë në leksikografinë shqiptare të cilën e botoi:



Frang Bardh

**Veprën e parë leksikografike, fjalorin Latinisht – shqipe, e botoi Frang Bardhi në vitin 1635.** Leksikologjia studion fjalorët dhe leksikografi i parë shqiptar është Frang Bardhi. Bardhi është autori i tretë i rëndësishëm i letërsisë së vjetër shqiptare. Fjalorin e botoi në Romë. Në këtë fjalor Bardhi përfshiu edhe disa 113 proverba shqipe. Frang Bardhi ishte edhe një nga të parët folklorist e etnograf shqiptar.

30. Kush mblodhi në Kosovë anekdota popullore, folklor e etnologji shqiptare?



Anton Çetta

**Në Kosovë ka mbledh anekdota popullore, ka sistemuar folklor e etnografi shqiptare profesor Anton Çetta.** Në vitet 90-të nis me disa bashkëpunëtorë Lëvizjen gjithëkombëtare, historike për faljen e gjaqeve dhe pajtimeve në Kosovë. Në historinë tonë më të re kjo Lëvizje e profesor Çettës për të bashkuar shqiptarët në atë kohë kur Serbia bëhej gati për t’na zhdukur nuk do të harrohet kurrë për shumë arsye. Anton Çetta drejtoi për shumë vite Sektorin e Folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Ai u bë njohës i thellë dhe studiues i spikatur i kulturës popullore, dokeve, riteve, miteve shqiptare e më gjerë. Kishte mbaruar Liceun e Korçës dhe kishte studiuar Romanistikë në Beograd. Vdiq në Prishtinë në vitin 1995.

31. Sot, shkolla shqipe funksionon mirë edhe jashtë atdheut. Dëshmi e gjallë është edhe ky kuiz i sotëm këtu në Suedi. Por, pesëqind vjet më parë ishte **Marin Beçikemi** që hapi shkollën e parë jashtë atdheut. Në cilin qytet të Italisë u hap kjo shkollë?



Pamje nga Venediku

**Mes viteve 1500 – 1504 shkodrani Marin Beçikemi hapi të parën shkollë shqipe në Venedik të Italisë.** Mësues të parë ishin Beçikemi dhe Marin Barleti. Objekti i shkollës u ngritë me ndihmën e mërgimtarëve shqiptarë që jetonin në këtë qytet. Fasada e jashtme e këtij objekti paraqet pamje nga lufta e popullit tonë për liri dhe për habi, si e tillë ruhet edhe sot.

32. Voskopoja dikur ishte qendër e rëndësishme kulturore jo vetëm për shqiptarët. Kishte shkollën e vet të quajtur “Akademia e Re” si dhe shtypshkronjën. Në cilin shekull Voskopoja ishte qendër e famshme e arsimit dhe e kulturës shqiptare?



Pamje nga Voskopoja

**Në shekullin e XVIII qendër shumë e rëndësishme arsimore e kulturore në jugun e Europës ishte Voskopoja.** Voskopoja shtrihet 13 km në perëndim të Korçës. Kishte shtypshkronjën e vet që ishte e para në Ballkan dhe Bibliotekën e njohur. Në vitin 1720 u themelua shkolla e mesme e quajtur “Akademia e Re” në të cilën jepnin mësim Teodor Kavaljoti, Anonimi i Elbasanit, Dhaskal Todri etj. Voskopoja ishte edhe qendër e artit pamor. Aty pikturuan Kostantin e Athanas Zografi, Thedhor Sino veprat e të cilit janë gjetur edhe në Hungari, Slloveni, Serbi, Austri etj. Në Voskopoje u përkthyen në shqip Ezopi dhe shumë libra fetare.

33. Si quhet romani i fundit i Kadaresë i përkthyer ne suedisht në prill të vitit 2007?



Ballina e romanit  
”Prilli i thyer” në suedisht

**Vepra e fundit e Ismail Kadaresë përkthyer në suedisht titullohet “Grymnia april”.** Vepra është përkthyer nga frëngjishtja në suedisht ndërsa romani në shqip titullohet “Prilli i thyer”. Edhe kjo vepër është botuar nga shtëpia botuese me famë në Suedi Albert Bonniers Förlag dhe vepra është mirëpritur e shoqëruar me kritika të shumta afirmative.

34. Tekstin e hymnit tonë kombëtar e shkroi ?



**Tekstin e hymnit tonë kombëtar e shkroi Asdreni.**

Asdreni shkroi edhe këto vepra:

Rreze dielli (1904)

Ëndrra e lotë (1912)

Psalme murgu (1930)

Kambana e Krujës (1937)

35. Si quhet drama e parë e shkruar në gjuhën shqipe?

**„Emira“ e Anton Santorit është drama e parë e shkruar në gjuhën shqipe.**

36. Librin me vjersha “Baba Tomori” dhe komedinë e bukur “14 vjeç dhëndër” e shkroi?



Andon Zako Çajupi

**Veprat “Baba Tomori” dhe komedinë “Katërmbdhjetë vjeç dhëndër” i ka shkruar Çajupi.**

37. Në lëtersinë tonë një shkrimtar i madh quhet Poet i mjerimit. Po, kush është ky poet i dashur që me art luftoi mjerimin shoqëror të kohës së tij?



Migjeni

**Ky poet i madh është Migjeni.**

Migjeni u lind në Shkodër në vitin 1911. Ka shkruar veprën e njohur “Vargjet e lira” në vitin 1936. Vdiq në Itali në vitin 1938, ende pa i mbushur 28 vjet. Është shkrimtar shumë i dashur nga lexuesit shqiptarë.

38. Vjershat e bukura “Vdekja e Nositit” dhe “Poradeci” i shkroi lirikë më i madh i shekullit XX. Kush është ky shkrimtar?



Shtatorja e  
Lasgush Poradecit

**Ky shkrimtar i madh i letërsisë shqiptare ( lirikë më i madh i shekullit XX ) është Lasgush Poradeci.**

Lasgushi ka shkruar këto vepra:

“Vallja e Yjve” – lirikë 1933

“Ylli i zemrës” – lirikë 1937

“Ekskursion teologjik i Sokratit”

“Mbi ta”

“Kamadeva”

U lind në vitin 1899 dhe vdiq më 12 nëntor të vitit 1987.

39. Në Spanjë luftoi fashizmin, në letërsinë tonë botoi poezi, tregime, romane dhe përktheu bukur nga gjuhët tjera në shqip. Lexuesit shqiptarë e kujtojnë me respekt sidomos për romanin “Hasta la vista”. Fjala është për...?



Petro Marko

**Fjala është për romancierin e njohur shqiptar Petro Marko.**

Petro Marko ka shkruar këto vepra:

“Hasta la vista” 1958, “Qyteti i fundit” 1960, “Një emër në katër rrugë”, “Ara në mal”, “Nata e Ustikës”, “Shpella e piratëve”, “Horizont” etj.

40. U doktorua për ekonomi në vitin 1934 por që në fillim u bë shumë i njohur si shkrimtar. Në historinë e letërsisë sonë nis i pari fillet e prozës moderne shqiptare. Shkroi “Poemin kosovar”, “Sulm e lotë”, “Tregime të moçme shqiptare” etj. Si quhet ky shkrimtar?



Mitrush Kuteli

**Ky shkrimtar quhet Mitrush Kuteli.**

Kuteli shkroi shumë vepra. Ja disa prej tyre:

”Net shqiptare”, ”Pylli i gështenjave”, Ago Jakupi e rrëfime tjera”, “Sulm e lotë”, “Shënime letrare”,

“Baltë e tokë”, “Në një cep të Ilirisë së

poshtme”, “Tregime te moçme shqiptare” etj.

41. Romani “Lumi i vdekur” ka për subjekt dashurinë mes Adilit kosovar e Vitës myzeqare. Kush e shkroi “Lumin e vdekur”- romanin me përmbajtje gjithëshqiptare dhe stil të përkryer?



Jakov Xoxa

**Këtë roman të bukur të letërsisë sonë e ka shkruar Jakov Xoxa.**

Xoxa ka shkruar edhe këto vepra:

“Lulja e kripës” dhe  
“Juga e bardhë”

Jakov Xoxa është një nga stilistët më të mëdhenj të prozës shqipe.

42. Kush ka shkruar këto vepra: “Njeriu me top”, “Komisari Memo” Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” etj,?



Dritëro Agolli

**Këto vepra i shkroi Dritëro Agolli.**

Lexuesit i lexojnë më dëshirë vjershat e tij, këngëtarët i këndojnë me kënaqësi poezitë e tij (kujto “Poçari” ), regjisorët bënë filma disa nga romanet e tij (kujto filmat: “Komisari Memo” e “Njeriu me top”). Është përkthyer në disa gjuhë botërore. Romani satirik “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” pati shumë sukses në frëngjisht.

43. Romanet “Dhjetori i shqetësuar” dhe “Dikush me buzëqeshte” janë vlerësuar lart nga kritika letrare. Autori i këtyre veprave është ...?



Fatos Arapi

**Ky shkrimtar është Fatos Arapi.**

Edhe romanet edhe poezitë e tij janë kryevlera të letërsisë sonë të re. Arapi ka shkruar poezi të fuqishme dhe prozë mjaftë interesante.

44. “Miq, Kosova është gjaku im që nuk falet” – tha kur ishte fare i ri shkrimtari gjakovar që sot është poeti më i madh i Kosovës. Është përkthyer në shumë gjuhë dhe ka marrë shumë shpërblime letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Si quhet poeti?



Ali Podrimja

**Ky poet shqiptar quhet Ali Podrimja.**

Podrimja ka filluar të shkruajë poezi fare i ri. Librin e parë me poezi e boton kur ishte në gjimnaz (“Hija e tokës”). Ka shkruar shumë vepra. Ja disa prej tyre: “Dhimbë bukur”, “Sampo”, “Torzo”, “Lum, lumi”, “Zari”, “Buzëqeshje në kafaz” etj. Ka botuar edhe dy libra me prozë: “Burgu i hapur”-1998 dhe “Harakiri”-1999. Jeton në Prishtinë.

45. U lind në Rugovë më 1938. Kur u bë poet tha:

*“Mos u bëj poet nëse s’ mund të vdesësh  
për secilin varg, të vdesësh për secilën fjalë”.*

Vepra “Karvani i bardhë” e bëri romancier modern shumë të njohur në Kosovë. Si quhet shkrimtari?



Azem Shkreli

**Ky shkrimtar i madh i Kosovës quhet Azem Shkreli.** Ka botuar këto vepra me poezi: “Bulzat”, “Ëngjujt e rrugëve”, “E di një fjalë prej guri”, “Nga bibla e heshtjes”, “Pagëzimi i fjalës”, “Nata e papagajve”, “Lirikë në shi”, “Zogj në gurë” etj. Ka shkruar edhe këto vepra në prozë: “Karvani i bardhë”, “Sytë e Evës”, si dhe dramat: “Fosilet” dhe “Varri i qyqes”. Poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë. Ishte drejtor i Kosovafilm-it dhe i Teatrit kombëtar. Vdiq në pranverën e vitit 1997 në Prishtinë.

46. Vjersha “Mori Shqypni e mjera Shqypni” (botuar më 1873) është një nga poezitë më të njohura dhe më popullore në mbarë letërsinë shqiptare. Kush e shkroi?



Pashko Vasa

**Vjershën “Mori Shqypni e mjera Shqypni” e shkroi Pashko Vasa.**

Ishte shkrimtar e luftëtar i madh i Rilindjes kombëtare. Punoi edhe si diplomat, shërbeu sekretar në ambasadën e Britanisë së Madhe dhe guvernator në Liban. Vjersha “Mori Shqypni...” u bë një hymn i shqiptarëve. Në vitin 1890 boton në frëngjisht romani e parë shqiptar “Bardha e Temalit” në Paris. Vdes në Liban në vitin 1892 kurse pas Luftë së Dytë eshtrat iu sollën në vendlindje.

47. Kur u shfaq si krijues pati pak lexues e shumë mohues. Shkroi kryesisht prozë moderne si bie fjala romanin “Oh!”. Është ky...?



Anton Pashku

**Është ky shkrimtari i njohur Anton Pashku.**

Ky shkrimtar në fillim nuk është kuptuar mirë nga lexuesit tanë. Për kohën kur u paraqit ishte shumë modern në prozën tonë. Më vonë është kuptuar rëndësia e tij në letërsinë tonë. Ka shkruar këto libra me tregime: “Kulla”, “Kjasina”, “Lutjet e mbrëmjes”; dramat: “Gof”, dhe “Sinkopa” si dhe romani “Oh!”. U lind në vitin 1937 në Prizren dhe vdiq në vitin 1995 në Prishtinë

48. U lind në Plavë të Malit të Zi më 1916. Botoi librat me poezi: "Për ty", "Avsha Ada" dhe "Brigjet". Ky shkrimtar është...?



Esad Mekuli

**Ky shkrimtar është Esad Mekuli.**

Ishte një nga shkrimtarët më të mëdhenj shqiptarë në Mal të Zi. Ka botuar këto vepra: "Për Ty", "Avsha Ada" dhe "Brigjet". Ka përkthyer në shqip letërsi të huaj dhe ka drejtuar për shumë vite revistën letrare të njohur dikur në Kosovë "Jeta e Re". Për punën e tij atdhetare është burgosur nga regjimi jugosllav i kohës. Me profesion ishte doktor i shkencave veterinarë. Vdes në Prishtinë në vitin 1993. Mori edhe shumë shpërblime letrare.

49. Cili lloj i letërsisë është më i hershëm?

**Letërsia gojore është lloj më i hershëm i letërsisë.**

Kur u zbulua shkrimi lindi një art i ri më emrin letërsi.

50. Kur poeti përdorë lidhëzat (**si, porsì, ashtu si**) në vjersha apo këngë popullore si bie fjala: "Syri i saj si qershi, goja si kuti ..." atëherë themi se përdorë figurën stilistike të quajtur?

**Atëherë poeti apo këngëtari përdorë figurën stilistike të quajtur Krahasim.**

Shënim: Për të formuluar pyetjet është marrë në konsideratë "Kurrikula e shkollës shqipe të mësimin plotësues në diasporë" të botuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Republikës së Kosovës në nëntor të 2007.